



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

---

Numri i lëndës: 2019:268890  
Datë: 18.03.2022  
Numri i dokumentit: 02815272

ARJ.nr. 1/2022

Gjykata Supreme në Prishtinë, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani kryetar, Shukri Sylejmani dhe Muhamet Rexha anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ të paditësit, “C....”, SHPK, me seli në G....., kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës,(ATK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit lidhur me rivlerësim-tatim shtesë, nr.64/2017,të datës 31.03. 2017, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të ushtruar nga e paditura ATK, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA. nr. 715/2021, të datës 28.10. 2021, në seancën e mbajtur me datë 28 Shkurt 2022, merr këtë;

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga i padituri, Administrata Tatimore e Kosovës, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, AA. nr. 715/2021, të datës, 28.10. 2021.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit- Departamenti për çështje administrative AA. nr. 715/2021, të datës 28.10.2021, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurit ATK, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A nr. 749/2017, i datës 23.03.2021, vërtetohet.

I padituri ATK, në këtë gjykatë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor me të cilën e konteston ligjshmërinë e aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljes së dispozitave procedurale dhe aplikimit të gabuar të ligjit material. Propozon që kërkesa e të paditurit ATK, të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i atakuar i Gjykatës së Apelit, AA nr. 715/2021 i datës 28.10.2021, të ndryshohet, ashtu që të të aprovohet ankesa e ATK ndaj aktgjykimit, A nr. 749/17, të Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, dhe të mbetet në fuqi ,Vendimi i ATK-së, me nr. 64/2017, i dates 31.03.2017.

Në përgjigjen në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditurit, paditësi kësaj gjykate i propozon që kërkesa të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Supreme në pajtim me nenin 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancë dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të kontestuar, sipas pretendimeve në kërkesë të paditurit, përgjigjes së paditësit, dhe shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit AA. nr.715/2021, të datës 28.10.2021, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të paditurit ATK, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, divizioni fiskal, A nr. 749/2017 i datës 23.03.2021, me të cilin në pikën I., të dispozitivit APROVOHET si e bazuar, kërkesë padia e paditësit, “C.....”, SHPK me seli në Gj. ....në pikën II. ANULOHET Vendimi me nr. 64/2017, i datës 31.03.2017, i ATK-së. Në pikën III.OBLIGOHET e paditura ATK, që paditësit “C....”, tia kthej mjetet finaciare të inkasuara në emër të detyrimeve tatimore sipas Njoftim Rivlerësimit të datës 23.01.2017, për çështjen e trajtimit të Akulloreve falas dhe blerjeve investive, në shumë prej 256,896.03 Euro, (dyqind e pesëdhjet e gjashtë mijë, e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë euro, e zero tre cent), me interes të llogaritur në shkallën e përcaktuar nga Ministria e Financave, nga data e pagesës së detyrimeve tatimore, 24.07.2017, e deri në datën kur shuma e cekur referohet për pagesë në Ministrinë e Financave. Dhe në pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm, Gjykata Supreme pas ekzaminimit të aktgjykimit të kontestuar dhe shqyrtimit të pretendimeve nga kërkesa, përgjigjes në kërkesë të paditësit, ka gjetur që gjykata e shkallës së dytë ka vepruar drejtë me refuzimin si të pabazuar të ankesës së të paditurit dhe vërtetimin e aktgjykimit të shkallës së parë. Qëndrimin

juridik të Gjykatës së Apelit dhe të Gjykatës Themelore në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë, meqë aktgjykimet e atakuara nuk janë të përfshirë me shkelje të së drejtës materiale dhe dispozitave procedurale, ashtu si pretendon i padituri si në kërkesën e tij.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se Gjykatat e instancave më të ulëta, përkatësisht gjykata shkallë së parë duke vendosur në ri procedurë sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve sipas Aktvendimit të Gjykatës së Apelit AA nr. 240/2020 të dt. 09.07.2020, pas vlerësimit të provave të administruara, ekspertizës financiare të dt. 18.01.2021 dhe plotësimit të saj të 15.03.202, deklarimit të palëve, ekspertit dhe dëshmitarëve në seancën kryesore të mbajtur me datë 23.03.2021, në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendja faktike të çështjes në bazë të rezultatit të gjithë procedimit me vendosjen meritore si në dispozitiv të aktgjykimit, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, nenit 81.1 par.,2 pika 2.2, të Ligjit nr.04/L-102, për ndryshimet dhe plotësimet e ligjit për ATK dhe procedurat nr. 03/L-22, dhe nenin 46 par. 2,3 dhe 5 të LKA-së., bazuar në faktet e paraqitura në arsyetim të mbështetura në dispozita ligjore tatimore, kur gjen se e paditura ATK-Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj (DTM), me dt. 23.01.2017, duke vendosur në ri procedurë sipas njoftim rivlerësimit me ri kontrollë, në mënyrë të gabuar ka konstatuar gjendjen faktike dhe si pasojë ka aplikuar gabimisht të drejtën materiale dhe pa të drejtë e ka obliguar paditësin me detyrime tatimore shtesë, në shumë prej 256,896.03, për periudhën tatimore 2009-2012, për akulloret të cilat paditësi i ka marrë falas në këtë periudhë kohore me qëllim të promovimit nga ekspertuesi i mallit nga Turqia ,”N. G.”, të cilat e paditura i ka trajtuar si të hyra- shitje, e po ashtu blerjet investive të paditësit i ka trajtuar si shitje në vitin 2011, për subjektin tjetër të pronarit –paditësit,” G. C....”,SHPK e themeluar me datë 13.12.2011.

Nga dokumentacioni në shkresa të lëndës, si dhe ekspertiza financiare në mënyrë të pa kontestueshme provohet se paditësi në periudhën kohore, 2009-2012, ka marrë një sasi të Akulloreve falas nga eksportuesi në emër të promovimit . Në vitin 2009, kuti falas kanë qen 17850 , në vitin 2010 kuti falas 47880, për vitin 2011, 57184 kuti falas, dhe për vitin 2012, 57965 kuti falas, të gjitha me akullore. Pastaj bazuar në këto evidenca, paditësi akulloret e pranuar falas i ka trajtuar si shpenzime të promovimit duke bërë zbritjen e të hyrave dhe TVSH-së, me çmimin e njëjtë siç ishin regjistruar me rastin e blerjes, në fund të vitit me regjistrim me komision, pas identifikimit të sasisë falas, pas grumbullimit të mbajtëseve (shkopinjëve) të akulloreve, në sasinë e cekur si më lartë.

Prandaj në të drejtim gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë vlerësojnë se, nuk është i qëndrueshëm arsyetimi i të paditurës si në vendimin e saj lidhur me mos pranimin e vlerës së

kompensimeve sipas faturave të emërtuara nga paditësi me emërtim, “shpenzime vetanake”, sepse sipas ATK-së, të njëjtat janë pranuar si blerje në momentin e importimit dhe janë llogarit si të hyra për biznesin dhe nuk ka të drejtë të shfrytëzohen dy herë për TVSh-në e zbritshme për të njëjtin mall, duke u thirrur në nenin 36 të Ligjit 03/L-114. Gjykata këtë gjendje të konstatuar nga e paditura nuk e aprovon si të drejtë dhe ligjore duke u bazuar edhe në ekspertizën financiare të cilës ja fali besimin në tërësi si profesionale, nga e cila konstatohet se akulloret falas, kontrolli tatimor i ka trajtuar me çmim të rregullt, gjer sa sipas dispozitave ligjore tatimore, akulloret falas (të promovimit), nuk hyjnë në asnjërën kategori të shpenzimeve të pa lejueshme. E paditura nuk e mohon faktin që paditësi nga eksportuesi ka pranuar sasinë e cekur të akulloreve falas për periudhën 2009-12, për çka paditësi për këto nuk ka realizuar të hyra, gjer sa e paditura akulloret falas i trajton si të hyra duke e ngarkuar paditësin me obligime tatimore shtesë. Prandaj gjykatat e instancave më të ulëta me të drejtë vlerësojnë se paditura nuk ka vepruar drejtë dhe sipas ligjit kur e ngarkon me qarkullim dhe tatim shtesë paditësin, duke e trajtuar si furnizim të mallit siç janë trajtuar akulloret e tjera të cilat janë blerë dhe janë shitur nga paditësi sipas çmimit të deklaruar. Nga kjo gjendje e vërtetuar gjykatat vlerësojnë se nga e paditura nuk janë zbatuar drejtë dispozitat ligjore nga neni 6,8, Ligji nr.03/L-114, nenet 3,10,22,24, 36, të Ligjit 02/L-146 për TVSH, nenet 3,4,7 të Ligjit 03/L-113, për të Ardhurat e Korporatave, nenet 4,5,8,9 të Ligjit 03/L-162 për TAK, sepse në këtë rast nuk ka ndodhur furnizimi i mallit për tu konsideruar të hyra të rregullta me dhënien e akulloreve falas siç kërkohet me ligj, dhe për tu ngarkuar me obligime tatimore shtesë, sepse në fund të vitit është bërë zbritja e të hyrave dhe TVSH pasi që më herët njohja e këtyre shpenzimeve si shpenzime të promocionit nuk është ditur me që nuk është ditur sasia e akulloreve falas. Prandaj trajtimi i akulloreve të dhëna falas sipas vlerësimit të gjykatës nuk ka bazë ligjore të trajtohen për tu tatuar siç ka vepruar e paditura.

Sa i parket vlerësimeve të gjykatave të instancave më të ulëta lidhur me çështjen e blerjeve investive, nga subjekti “C...”, për vitet 2010-11, në shumë prej 624,622.24€ të cilat e paditura në ri kontroll i ka trajtuar si shitje dhe duke e ngarkuar paditësin me TVSH, ndërsa paditësja e ka mohuar këtë, kjo gjykatë po ashtu i pranon si të drejta dhe ligjore qëndrimet e gjykatave më të ulëta kur gjejnë se, e paditura nuk ka vepruar drejtë, sepse duke u bazuar në shkresat e lëndës, bazat ligjore dhe ekspertizën financiare të kryer nga eksperti ka rezultuar se, të gjitha këto blerje janë realizuar për subjektin “C.....”, kjo është vërtetuar edhe me faktin se subjekti tjetër “G. C.”, sh.p.k., është regjistruar si biznes në ARBK me datë 13.12.2011, gjer sa këto blerje i takojnë periudhës kohore të vitit 2011, dhe nuk provohet se ka ndodhur asnjë nga momentet me të cilat parashihet që të bëhet ngarkimi me TVS-së, (dërgimi i mallit apo shërbimi i faturimi apo

pagesa e as nuk ka munguar mungesa e stoqeve të blerjeve investive). Sipas ekspertizës të gjitha kanë qenë tek paditësi, ashtu që nuk janë plotësuar kushtet si parashihet në nenin 22 të Ligjit nr.03/L-146 për TVSH-në, i cili rregullon momentin e lindjes së detyrimit dhe ngarkimit me TVSH, për furnizimet e mallrave dhe shërbimeve, sepse nuk është dëshmuar me prova se paditësi ka bërë shitjen e pajisjeve, (blerjeve të më hershme investive), për vitin 2011, gjer sa edhe përkundër se kishte bërë një kontratë me “G. C...” sh.p.k., shitja nga ekspertiza financiare dhe shkresave të lëndës nuk dëshmohet se ka ndodhur. Prandaj ligjërisht rezulton se gjer sa nuk është bërë shitja nuk mund të bëhet edhe ngarkimi me TVSH, ashtu si parashihet në nenin e cekur 22 ,citim, *Rregullat e përgjithshme: “Momenti i lindjes së detyrimeve ndodh dhe TVSH bëhet e ngarkueshme kur bëhet furnizimi i mallit dhe shërbimeve”*. Më detajisht kjo çështje sqarohet sipas nenit 14, të U.A. 10/2010, lidhur me zbatimin e nenit 22 të lartë cekur. Gjer sa faturimi i blerjeve investive të “C.” SHPK, për subjektin “G. C.... “, shpk, për vitin 2012, ka qenë në përputhje me legjislacionin tatimor dhe udhëzimet administrative që kanë qenë në fuqi në periudhën e kontrollit.

Gjykata e Apelit duke vendosur sipas ankesës së të paditurit si në kuptim të nenit 49 të LKA dhe 81 h. Të Ligjit 04/L102 dhe nenit 194 të LPK, pasi bën përshkrimin dhe sqarimin e gjendjes faktike të çështjes të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, dhe duke u bazuar dhe cituar dispozitat ligjore materiale të njëjta, lidhur me trajtimin e akulloreve falas dhe çështjes së blerjeve investive, për të njëjtat shkaqe dhe arsye, qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë e pranon në tërësi si të drejtë dhe ligjor, duke vlerësuar se gjendja faktike nga gjykata e shkallës së parë është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, e po ashtu nuk janë bërë shkelje qenësore të dispozitave ligjore me vendosjen meritore të çështjes nga gjykata e shkallës së parë. Pretendimet ankimore të paditurës i refuzon si jo të bazuara apo me ndikim për tu vërtetuar gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar se nuk është cenuar e drejta dhe ligji në dëm të paditurës.

Nga gjendja e theksuar si më lartë, kjo gjykatë në tërësi e aprovon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta, sepse nuk provohet se aktgjykimet e kontestuar janë të përfshirë me shkelje procedurale dhe të drejtës materiale ashtu si pretendohet. Në këtë çështje drejtë është vërtetuar gjendja faktike me vendosjen meritore dhe aprovimin e kërkesë padisë së paditësit si në kuptim të nenit 81.I par. 2 pika 2.2 të Ligjit nr. 04/L-102, për ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për ATK dhe procedurat dhe neni 38 dhe 46 të LKA-së, nga gjykata e shkallës së parë, bazuar në provat e administruara, ekspertizën financiare dhe faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimimit të mbështetura në dispozitat materiale, Ligjit për TVSH,

për të Ardhurat e Korporatave, TAK, dhe ATK-në dhe procedurat, me të drejtë është vërtetuar se në bazë të dokumentacionit të paraqitur nga paditësi, është dëshmuar se pa të drejtë është ngarkuar me detyrime tatimore shtesë, prandaj është obliguar e paditura t'ia kthej mjetet financiare të inkasuara në emër të detyrimeve tatimore shtesë, sipas raportit të ri kontrollit të dt. 23.01.2017, për çështjen e trajtimit të akulloreve falas dhe blerjeve investive.

Pretendimet e të paditurës si në kërkesë të cekura si më lartë lidhur me shkeljet e të drejtës materiale dhe procedurale nga gjykata e shkallës së dytë, si dhe theksimet ndër të tjera si në arsyetim të saj se; Gjykata e shkallës së parë e ka anuluar vetëm vendimin nr. 64/2017 e jo edhe njoftim rivlerësimin prej të cilit rrjedhin obligimet tatimore shtesë, andaj aktgjykimi i dytë i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje nga nenin 182 par.2 pika (n), të LPK, se gjykata e shkallës së dytë nuk e ka shqyrtuar si në kuptim të nenit 194 të LPK aktgjykimin e ankimor, mandej se gjykatat më të ulëta nuk kanë vërtetuar gjendjen faktike të çështjes drejtë dhe ligjërisht sipas dispozitave materiale të lidhur me akulloret falas dhe blerjet investive të realizuara nga paditësi dhe me këtë kanë bërë shkelje të dispozitave ligjore nga neni 3, 10, 24 dhe 36 të Ligjit nr. 03/L-146 për TVSH, sepse paditësi TVSH-në e zbritshme dhe KMSH, e ka marrë me rastin e importimit, sepse i kishte regjistruar si importe të tatueshme dhe po ashtu i ka njohur si të hyra dhe në të njëjtën kohë edhe si shpenzime operative, andaj nuk mundet e njëjta blerje të shfrytëzohet për zbritje të lejueshme përsëri, se këto akullore janë kompensuar nga eksportuesi etj. Kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjerat së në kërkesë i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i refuzon si të pa bazuara në prova dhe fakte të dëshmuara sipas bazave ligjore në të cilat thirret lidhur me çështjen e vendosur, andaj nuk janë të qëndrueshme dhe me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje nga ajo e vendosur nga gjykatat e instancave më të ulëta, të cilat si në aktgjykimet e tyre kanë vendosur drejtë sipas gjendjes së vërtetuar dhe bazave ligjore materiale, duke dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me mënyrën e vendosjes, të cilat fakte vendimtare i aprovon edhe Gjykata Supreme. Nuk janë të qëndrueshme theksimet lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës nga neni 182, par. 2 (n), të LPK-së, sepse aktgjykimi i shkallës së parë dhe ai i shkallës së dytë janë të qartë dhe të arsyetuar mjaftueshëm për të gjitha faktet vendimtare relevante për gjykimin e drejtë të kësaj çështje, të cilat arsye si të drejta dhe të plota i pranon edhe jo gjykatë. Qëndron si i drejtë i qartë dhe ligjor diapozitivi i aktgjykimit të shkallës së parë, andaj nuk janë të qëndrueshme theksimet në këtë drejtim në kërkesë të paditurës, “se është anuluar vetëm vendimi i organit të paditur e jo edhe njoftim rivlerësimi”, sepse objekt i shqyrtimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë në procedurë të konfliktit administrativ në këtë lëndë është akti përfundimtar i organit të paditur Vendimi nr. 64/2017 i dt.

31.03.2017, andaj me anulimin e tij si kundër ligjor si në dispozitivin e aktgjykimit të shkallës së parë, kuptohet se e gjitha çështja e vendosur sipas tij dhe lidhur me rivlerësimet e bëra nga e paditura të dt. 23.01.2017, anulohen me anulimin e tij si akt përfundimtar.

E paditura nuk ka paraqitur prova të kundërta ligjërish të pranueshme në procedurë gjyqësore në asnjë fazë gjer thirrjet e saj në dispozitat ligjore të cekura si më lartë nuk janë konkrete dhe adekuate në bazë të cilave do të vendosej ndryshe çështja lidhur me objektin e çështjes, trajtimi i akulloreve falas si dhe blerjeve investive, sipas gjendjes faktike të vërtetuar në shqyrtim kryesor gjyqësor, pas deklarimit të e përfaqësuesve të palëve në procedurë, dëshmitarit, ekspertit dhe ekspertizës financiare dhe bazave ligjore në të cilat bazohet, ku pa dyshim dëshmohet që kërkesë padia e paditësit është e bazuar, ashtu si ka vendosur gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të saj, të anulohet vendimin e organit të paditur, dhe në pikën III. të dispozitivit në obligoj të paditurin që paditësit t'ia kthej shumën e inkasuar në emër të detyrimeve tatimore shtesë sipas njoftim rivlerësimit sipas raportit të ri kontrollit të dt. 23.01.2017, për çështjen e trajtimit të akulloreve falas dhe blerjeve investive, në shumën prej 256, 896.03€.

Nga theksimet si më lartë, Gjykata Supreme vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta në këtë çështje juridike administrative, drejtë kanë aplikuar dispozitat procedurale, në arsyetimin e e aktgjykimeve të tyre janë dhënë arsye të qarta dhe të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cila i pranon edhe kjo gjykatë. Në këtë çështje nuk janë cënuar dispozitat e LPA-së, të LKA-së, e po ashtu nuk është bërë zbatim i gabuar i së drejtës materiale, dispozitave ligjore të Ligjit për TVSH, për të Ardhurat e Korporatave, TAK, dhe ATK-në dhe procedurat.

Nga theksimet si më lartë, dhe në bazë të nenit 54 paragrafi 1, i Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË

ARJ Nr. 1/2022, me datë 28 shkurt 2022

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani